

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Shkurt, 2018


Tiranë, më 23 Mars 2018: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Shkurt 2018 është 493.564, krahasuar me Shkurt 2017, ky tregues rezulton me rritje 6,3 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 190.531, krahasuar me Shkurt 2017, ky numër është rritur me 2,6 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në dymujorin e parë 2018 është 422.869, duke u rritur 18,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Në Shkurt 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe me 19,2 %, ndërsa uljen më të madhe e ka patur Maqedonia me 14,3 %.

Në dymujorin e parë 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe me 23,3 % .

Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në muajin Shkurt 2018, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej me 80,3 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore zënë 15,7% dhe detare zënë 4,0 %.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Shkurt 2018, janë 494.945 duke shënuar një rritje me 2,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shkurt 2018, është 299.489. Krahasuar me Shkurt 2017, ky numër është rritur 0,7 %. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shkurt 2018, është 195.456. Krahasuar me Shkurt 2017, ky numër është rritur 6,0 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në dymujorin e parë 2018, është 1.221.408, duke u rritur 17,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Shkurt 17	Shkurt 18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Shkurt 17	Janar-Shkurt 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje gjithsej	464.485	493.564	6,3	932.647	1.099.008	17,8
Shqiptarë	278.764	303.033	8,7	574.169	676.139	17,9
Të Huaj	185.721	190.531	2,6	358.478	422.869	18,0
Dalje gjithsej	481.613	494.945	2,8	1.039.722	1.221.408	17,5
Shqiptarë	297.279	299.489	0,7	668.320	747.592	11,9
Të Huaj	184.334	195.456	6,0	371.402	473.816	27,6

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Shkurt 17	Shkurt 18	Ndryshim vjetor (%)	Janar- Shkurt 17	Janar-Shkurt 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Kosovë	63.021	63.466	0,7	120.503	140.687	16,7
Maqedoni	29.828	25.548	-14,3	55.114	62.759	13,9
Greqi	27.811	30.067	8,1	51.315	60.983	18,8
Itali	14.987	16.329	9,0	31.258	35.219	12,7
Angli	3.774	4.027	6,7	7.192	8.120	12,9
Mali i zi	21.778	21.994	1,0	42.538	49.873	17,2
Poloni	291	347	19,2	587	724	23,3
SHBA	2.575	2.721	5,7	5.627	6.276	11,5
Gjermani	2.126	2.202	3,6	4.632	4.917	6,2
Zvicër	829	910	9,8	2.430	2.560	5,3
Të tjera	18.701	22.920	22,6	37.282	50.751	36,1
Gjithsej	185.721	190.531	2,6	358.478	422.869	18,0

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

Periudha	Shkurt 2017	Shkurt 2018	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shkurt 2017	Janar-Shkurt 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	185.721	190.531	2,6	358.478	422.869	18,0
I. Personale	182.010	186.138	2,3	351.832	413.798	17,6
1. Pushime	30.652	23.178	-24,4	48.269	64.485	33,6
2. Vizitë në miq e të afërm	709	646	-8,9	1.235	1.467	18,8
3. Vizitë ditore	4.444	746	-83,2	17.201	6.919	-59,8
4. Trajtim shëndetësor	53	19	-64,2	96	41	-57,3
5. Qëllime fetare	45	53	17,8	71	94	32,4
6. Vizitorë të tjerë	139.452	153.086	9,8	269.697	322.192	19,5
7. Udhëtarë transit	6.655	8.410	26,4	15.263	18.600	21,9
II. Biznes dhe profesionale	3.711	4.393	18,4	6.646	9.071	36,5

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Shkurt 2017	69.499	21.501	373.485	69.462	23.262	388.889
Shkurt 2018	77.396	19.815	396.353	77.895	18.396	398.654
Ndryshimi vjetor (%)	11,4	-7,8	6,1	12,1	-20,9	2,5
Janar-Shkurt 2017	159.936	43.922	728.789	172.362	78.391	788.969
Janar- Shkur2018	177.994	41.789	879.225	191.714	65.280	964.414
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	11,3	-4,9	20,6	11,2	-16,7	22,2

Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>